



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin

PROCESVERBAL

Tiranë, më 01.10.2019, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Niko Peleshi – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Shqyrtimi i projektligjit “Për ratifikimin e kontratës financiare ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Europiane të Investimeve për projektin “Shtrati i lumit Lana – zhvillim urban” (*Komision për dhënie mendimi*)
2. Shqyrtimi i projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes së grantit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Europiane të Investimeve për projektin “Shtrati i lumit Lana – zhvillim urban” (*Komision për dhënie mendimi*)
3. Prezantimi i paketës antikorupsion në fushën e mjedisit (Komision përgjegjës)

Marrin pjesë:

Niko Peleshi , Halil Jakimi, Besnik Baraj, Ilir Beqaj, Gjetan Gjetani, Rrahman Rraja, Andrea Marto, Tatiana Nurçe, Ilir Ndraxhi, Arben Pëllumbi, Robert Bitri, Ardit Konomi, Dritan Bici, Halil Jakimi, Nimet Musaj, Zef Shtjefni, Kujtim Gjuzi, Halit Valteri dhe Ilirjan Pendavinji.

Mungojnë:

Lefter Koka, Arlind Çaçani dhe Eglantina Gjermani.

Të ftuar:

Belina Ikonimi – Zëvendësministre e Financave dhe Ekonomisë

Tedi Bushaj – Përfaqësues nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Arbi Mazniku – Nënkyetar i Bashkisë së Tiranës

Blendi Klosi – Ministër i Turizmit dhe Mjedisit

Adrian Kamenica – Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit
Enerieta Tarelli – Drejtor juridik në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit

HAPET MBLEDHJA

Niko Peleshi - Sot është data 1 tetor dhe ne kemi në shqyrtim projektligjin “Për ratifikimin e kontratës financiare, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Europiane të Investimeve, për projektin “Shtrati i lumit Lana – zhvillim urban”

Relator është zoti Besnik Baraj.

Kemi të ftuar zonjën Belina Ikonimi, zëvendësministre e Financave dhe Ekonomisë, zotin Tedi Bushaj, nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe zotin Arbi Mazniku, nënkryetar i Bashkisë Tiranë.

Urdhëroni, zoti Baraj!

Besnik Baraj - Faleminderit!

Është një investim që kap vlerën rreth 23-24 milionë euro. 8 milionë janë kredi, 2,4 është grant, kurse pjesa tjetër mbulohet nga bashkia.

Sigurisht, do të zbatohet nga bashkia. Bëhet fjalë për shtratin e lumit Lana, që është aq problematik, është në zonën në kufi mes njësive bashkiake nr.6 dhe nr.7, ku realisht ka shumë probleme mjedisore, pra është një domosdoshmëri.

Fillon thuajse te Pallati me Shigjeta dhe vazhdon deri te rruga “Teodor Keko”, që kthehet tek Unaza, ku ka një urë, poshtë së cilës kalon lumi Lana.

Unë kam disa pyetje, thjesht edhe për informacion.

Te njësia nr.7 (por ndoshta edhe më shumë te njësia nr.8), janë 131 banesa, të cilat janë pa leje sot, por padyshim përbëjnë një problem social dhe mund të kemi situata të ngjashme me Astirin.

A është menduar ndonjë lehtësim për këta banorë? A është parashikuar ndonjë asistencë?

Sa kilometër është pjesa nga ura pranë pallatit me shigjeta deri te rruga “Teodor Keko”?

A ka ndonjë plan në lidhje me vazhdim edhe më tutje, meqë ajo pjesë është brenda Tiranës dhe problemet mjedisore që hasim do të jenë përsëri evidente në segmentin që nuk bëhet kjo lloj ndërhyrjeje?

Do të doja të dija për kuriozitet, meqenëse ujërat e zeza në Tiranë nuk trajtohen, a ka ndonjë projekt në lidhje me trajtimin e ujërave të zeza?

Ne flasim për trajtimin e ujërave bregdetarë në një kohë që qendra më e madhe urbane që dërgon në det ujërat e kontaminuar është Tirana. Di që JICA ka bërë një studim, po nuk përballohej dot nga pikëpamja financiare.

A kemi ndonjë projekt apo ndonjë iniciativë të fundit në lidhje me këtë?

Faleminderit!

Niko Peleshi – Urdhëroni, zonja Ikonomi!

Belina Ikonomi – Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar deputetë,

Këtu kemi drejtorin e projekteve në Bashkinë e Tiranës, i cili besoj se menjëherë do t'ju përgjigjet të gjitha pyetjeve.

Në mënyrë shumë të përmbledhur këto janë dy akte, të cilat janë paraqitur pranë jush lidhur me ratifikimin e marrëveshjes së grantit prej rreth 2,4 milionë euro dhe akti tjetër që ka të bëjë me kontratën financiare ndërmjet KM-së dhe Bankës Europiane të Investimeve në shumën 8 milionë euro.

Parashikohet që projekti i shtratit të lumit Lana të zbatohet nga Bashkia e Tiranës deri në shkurt të vitit 2022. Ky është një projekt shumë i rëndësishëm për infrastrukturën dhe prandaj edhe qeveria shqiptare ka kontribuar dhe sjellë për miratim pranë Kuvendit këtë marrëveshje.

Lidhur me detajet teknike unë do t'ia jepja fjalën, me lejen tuaj, drejtorit të projekteve të Bashkisë së Tiranës, për t'ju përgjigjur të gjitha pyetjeve.

Faleminderit!

Arbian Mazniku – Zoti kryetar,

Të nderuar deputetë,

Bëhet fjalë për një projekt zhvillimi urban për të cilin Bashkia Tiranë dhe BEI kanë punuar për rreth 1 vit e gjysmë, duke hartuar projektin së bashku dhe kjo është finalizuar me një marrëveshje financimi prej 8 milionë euro kredi me kushte shumë të favorshme e shoqëruar me një grant nga një *frame work*, i cili vjen në ndihmë të vendeve të Ballkanit. Ka gjithashtu edhe një grant tjetër për asistencën teknike, rreth 600 mijë euro, për përpilimin e projektit për të trajtuar më së miri çështjet sociale dhe mjedisore.

BEI ka vënë në gatishmëri një ekip prej 11 ekspertësh të huaj, të cilët kanë shkuar disa herë në terren së bashku me ekspertët e Bashkisë Tiranë, kanë bërë raportet e nevojshme dhe janë duke ndërtuar planin e zhvendosjes së banesave që ndodhen në dy brigjet e lumit.

Aktualisht, Bashkia Tiranë ka tre programe për zhvendosjen e të gjitha banesave që afektohen nga ky zhvillim urban.

Niko Peleshi – Urdhëroni!

Halit Valteri – Pash edhe te punimet e parlamentit që do të kalonte direkt në parlament. Pse kaq shpejt? Sot këtu dhe të enjten në parlament. Nuk është se ka ardhur më parë dhe ne e kemi neglizhuar. Unë s’e di që të ketë ardhur.

Niko Peleshi – Ka vetëm një teknikalitet, që java e kaluar ishte java e komuniteteve dhe të gjithë deputetët supozohet se kanë qenë në zonat e tyre. Ishte një udhëzim që të mos kishim mbledhje komisioni dhe asnjë veprimtari parlamentare gjatë javës, për t’u krijuar mundësi, sidomos deputetëve të zonave jashtë Tiranës të mund të shpenzojnë kohën e nevojshme për zonat e tyre.

Dje ka qenë një seancë e dedikuar për problemet në komunitet dhe për këtë arsye nuk e kemi bërë dot mbledhjen javën e kaluar, por gjithsesi asnjë urgjencë nuk justifikon mosrespektimin e procedurës së plotë.

Në qoftë se ne sot do të biem dakord ta votojmë marrëveshjen, edhe marrëveshjen tjetër të grantit që kemi më pas, i hapet rruga miratimit në seancë, përndryshe, për çdo gjë që mund të kemi do të marrim kohën që na duhet.

Niko Peleshi – Kam një pyetje për bashkinë.

A ka një projekt të përgjithshëm për shtratin e lumit Lana? Sa është gjatësia e segmentit që përfshin ky projekt?

Urdhëroni, zoti Valteri!

Halit Valteri – Ju nisët të diskutoni për tre programe për zhvendosjen e banesave. Unë jam deputet i njësisë nr.7 dhe jam shumë i shqetësuar për banesat që përfshihen nga ky projekt. Sa banesa preken gjithsej? Sa janë futur në programin tuaj për t’u dëmshpërblyer? Sa janë të legalizuara? Sa janë të palegalizuara dhe sa është kostoja e këtij projekti që të shpronësohen këta banorë? Jam shumë i sigurt se sapo të fillojë puna do të kemi një Astir të dytë tek ajo zonë. Prandaj do t’ju lutesha të na i specifikoni këto gjëra, jo vetëm për mua, por edhe për të gjithë ato që po na dëgjojnë.

Faleminderit!

Niko Peleshi – Urdhëroni, zoti Beqaj!

Ilir Beqaj – Nëse mund të na bëni një përshkrim të aspektit të plotë financiar, pra sa është i gjithë projekti, sa është kredia, sa është interesi, a ka normë interesi, se këto janë shumë të rëndësishme?

Faleminderit!

Niko Peleshi – Urdhëroni, zoti Marto!

Andrea Marto – Sa gjykojnë bashkia apo ministria se do të jetë vlera e shpronësimeve?

Niko Peleshi – A ka pyetje të tjera?

Dakord. Fillojmë me përgjigjet.

Ju lutem, një nga një, zoti Mazniku!

Arbian Mazniku – Për sa i përket pyetjes së parë, ky është segmenti i fundit i lumit Lana që është tërësisht urban. Pra, lumi Lana shtrihet në pjesën thellësisht urbane të qytetit, nga zona e Shkozës ose zona e ish- uzinës “Traktori”, e cila është tashmë në proces rehabilitimi dhe kahun tjetër, pika e fundit ku lumi bashkëvepron me pjesën urbane është pika ku lumi ndërvepron me rrugën “Teodor Keko” ose, siç e njohim ndryshe, me Unazën e Re.

Segmenti në fjalë, i cili është segmenti nga Pallati me Shigjeta deri te rruga “Teodor Keko” është i tëri në lëvizje natyrore, që do të thotë se lumi lëviz në mënyrë natyrore mes për mes shtëpive dhe në varësi të sasisë së ujërave ndërron edhe në mënyrë periodike edhe shtratin, siç ndodh rëndom me lumenj që lëvizin në shtrat natyror.

Kemi probleme masive gjatë gjithë këtyre viteve me përmbytjet në këtë zonë.

Segmenti i cili do të rehabilitohet është 1,8 km. Standardi i rehabilitimit është super i lartë. Edhe në atë pjesë që është tërësisht e degraduar do të kemi skarpitet e lumit, do të kemi skarpate të gjelbëruara, në secilin prej krahëve të lumit do të kemi tri korsi, njëra prej të cilave është korsi e dedikuar për autobus, do të kemi trotuar në secilin prej krahëve dhe korsi për biçikleta, duke e kthyer edhe atë segment në një segment të ngjashëm me atë të bulevardit ku lumi Lama përshkon qytetin.

Ky projekt do të ketë një ndikim të stërmadh në një territor të tërë, i cili në pjesën e hartës mendore të shumicës së qytetarëve të Tiranës, pothuajse nuk ekziston, pra shumica e njerëzve nuk e dinë se çfarë ndodh përtej asaj pike. Atje ka një seri banesash me njerëz që jetojnë më keq edhe se në zonat më të thella rurale, pavarësisht se është në një zonë të qenësishme të qytetit.

Pyetja e dytë, që ka të bëjë me programin e zhvendosjes, theksoj se ne kemi punuar gjerësisht për këtë çështje dhe BEI e ka një ndër prioritetet e saj këtë çështje, ndaj ata na kanë alokuar një fond të asistencës teknike, pikërisht për këtë program.

Ne jemi duke punuar ngushtësisht me ekspertët e tyre për identifikimin e secilës prej familjeve të prekura. Ka një mori tipologjish të llojeve të preken. Janë rreth 238 shtëpi që preken në këtë zonë, nga të cilat më pak se 10%, rreth 25 prej tyre kanë akt pronësie për shtëpinë. Një pjesë e madhe e shtëpive janë ndërtuar shumë afër lumit dhe kjo ka krijuar

problematika edhe për mundësinë e legalizimit të tyre, por programi që kemi na jep mundësi t'i sistemojmë të gjitha familjet në një mënyrë ose në një tjetër nëpërmjet tre programeve që kemi:

1. Programi i bonusit të qirasë, me të cilin ne i japim mundësi familjet të kenë një qira trevjeçare derisa të kenë mundësi të rivendosen diku tjetër.
2. Ka një program të posaçëm të ndërtimeve të banesave të reja sociale për këto familje.
3. Programi për banesa të tjera sociale, të cilat i disponon bashkia sot, apo akses prioritar i këtyre familjeve te programet e mbështetjes për strehim që ka bashkia.

Në mënyrë të vazhdueshme, sa herë bashkia ka pasur projekte të tilla të kësaj madhësie ose jo, njerëzit që preken nga këto programe futen automatikisht në programet e mbështetjes prioritare dhe në programet standarde. Në rastin konkret do të kemi edhe një program të posaçëm vetëm për këtë zonë.

Për sa i përket përshkrimit financiar, pyetja e zoti Beqaj, theksoj se kredia është 8 milionë euro, kemi një grant 2,4 milionë euro, kemi edhe një mbështetje 600 mijë euro, 0,6 milionë, të cilat janë mbështetje teknike që është jashtë këtij programi, por është mbështetje teknike për realizimin e këtij projekti.

Ka një periudhë 4-vjeçare në të cilën ne nuk paguajmë dhe fillon pas 4 vjetësh pagesa, ndërkohë që norma e interesit është shumë e ulët.

Niko Peleshi – Urdhëroni, zoti Valteri!

Halit Valteri – Zoti Mazniku,

Shqetësimi ynë nuk është se po ndërtohet kjo gjë, se është një gjë shumë e mirë që po bëhet. Rikualifikimi i lumit Lana është një çështje për të cilën unë di çdo detaj, se e di mirë situatën e asaj lagjeje atje.

Është e vërtetë që janë 25 ose 30 banesa, të cilat janë me certifikatë pronësie, por shumica e tyre janë në proces legalizimi. Po çfarë ndodh? Shumë nga këto familje kanë paguar edhe të gjitha faturat e legalizimit, por del një ligj ku thuhet se këtu kalon rrugë, këtu ka projekt dhe nuk ua jep mundësinë këtyre familjeve të marrin fletën e legalizimit. E ka bërë stil bashkia këtë gjë.

Po vë veten në vend të këtyre familjarëve. Unë kam ndërtuar një shtëpi që 25 vjet më parë dhe vjen bashkia një ditë dhe më thotë se do të të jap bonus qiraje, do të të nxjerr nga shtëpia se unë do të bëj rrugën këtu ose do t'i jap leje ndërtimi një subjekti (se aty do të bëhen pallate).

Kam një kërkesë, nuk e di se sa do ta zbatoni: ju lutem, trajtojini të gjithë në mënyrë të barabartë!

Certifikata e pronësisë është një copë letër, që dikush ka pasur një mik dhe e ka marrë, një tjetër ka paguar para nën dorë dhe e ka marrë, siç ka funksionuar (se edhe ju gjatë qeverisjes suaj keni pasur parti korporata, të cilat me 2-3 mijë euro të qelbura i jepnin lejet e legalizimeve), ndërsa atyre që s'kanë pasur mundësi ne t'u themi hajde të japim bonos qiraje dhe hajde dil nga shtëpia.

Për mendimin tim të gjithë njerëzit duhet të trajtohen në mënyrë të barabartë se njësoj ua merrni votën të gjithëve.

Unë jam shumë dakord dhe do të bëj lobimin maksimal tek opozita parlamentare që të bëhet ky projekt, por te çështja e shpronësimeve duhet të trajtohen të gjithë në mënyrë të barabartë. Ka lekë shteti për t'i trajtuar njerëzit. Kur i jepni lejen e ndërtimit atij subjektit, merrjani atij paratë ose hiqni nga 200-300 m te unaza e re dhe jepuni shtëpi këtyre banorëve, se nuk po kërkojnë vila luksoze.

Do të dalin në protesta njësoj si tek Astiri, por këndej do të jetë më e fortë se andej keni Klevis Balliun, kurse këndej keni njerëz të tjerë që nuk ju lëmë të bëni punë.

Faleminderit!

Arbian Mazniku – I nderuar zoti deputet,

Teksa e vlerësoj shumë ndjeshmërinë që duhet të kemi për njerëzit, më besoj se ne kemi po aq merak dhe po aq shqetësim për t'i treguar secilit banor të Tiranës, pavarësisht statusit dokumentar të tij, vëmendjen e posaçme që ai të ketë mundësi për të përfutur nga programet mbështetëse të bashkisë.

Ne kemi edhe një përgjegjësi përpara ligjit, i cili miratohet nga ky parlament. Ligji na thotë se ne mund të shpronësojmë njerëz që kanë titull pronësie dhe, sikur në një moment të caktuar të ishte në dëshirë, kjo çështje është përtej hapësirave ligjore.

Edhe arsyeja pse një pjesë e familjeve aty nuk janë legalizuar është, gjithashtu, një çështje ligjore, sepse duke qenë se janë ndërtesa shumë pranë shtratit të lumit, me rrezikshmëri të lartë. Kjo është arsyeja që edhe në vetë ligjin e legalizimit një pjesë e këtyre banesave nuk mund të legalizohen. Pra, në qoftë se do të merremi me diskutimin se pse nuk janë legalizuar, kanë apo nuk kanë titull pronësie, a mund të shpronësohen, këto janë çështje përtej vullnetit të bashkisë, pra janë çështje specifike ligjore.

Ne mendojmë se zgjidhja është përmes programeve të posaçme të mbështetjes, në mënyrë që këto njerëz të kenë mundësi për të pasur një banesë.

Është kollaj të thuhet se shteti i ka paratë për shpronësime, por ama secila qindarkë që ne shpenzojmë për shpronësime është para e munguar për t'u shpenzuar për një çerdhe, për një kopsht, për një rrugë tjetër apo për një përmirësim tjetër të qytetit. Ka edhe një debat për t'u bërë, në qoftë se duhet që nga paratë e taksapaguesve shqiptarë të paguajmë shumë para për dikë, i cili në mënyrë super të papërgjegjshme ka ndërtuar ngjitë me një vijë uji apo ngjitur me një lum, që përbën rrezikshmëri dhe vetë ligji i legalizimeve nuk ka lejuar që ato ndërtesa të legalizohen.

E rëndësishme është se nuk do të lëmë asnjë nga ato familje pa pasur vëmendjen dhe pasur një zgjidhje.

Niko Peleshi – Urdhëroni, zoti Baraj!

Besnik Baraj – Në relacion jepet informacion për fillimin e projektit, viti 2022. Sa parashihet të zgjasë ky projekt? Sigurisht aty zhvillimi do të kërkojë edhe objekte të munguara sot, por që janë shumë të kërkuara si çerdhe, kopshte, një shtëpi për shërbim shëndetësor e të tjera. Me siguri bashkia do t'i ketë parasysh këto, meqenëse edhe sipërfaqja aty do të riformatohet. Do të ishte shumë mirë të kihet në fokus nga ana e bashkisë.

Faleminderit!

Arbian Mazniku – Profesor Bare, ne shpresojmë t'i fillojmë punimet në pranverë dhe t'i mbyllim në një afat 30-mujor. Këtu përfshihen shpronësimet, lëvizja e banorëve e të gjitha me radhë. Ne shpresojmë se diku nga fundi i vitit 2022 ta kemi të përfunduar projektin. Ndërkohë, do të ishte mirë që fillimet t'i kishim pranverën e këtij viti, nëse kjo marrëveshje do të vijojë ashtu siç pritet.

Për të gjetur zgjidhjen më të mirë të mundshme për banorët që do të lëvizin, por edhe për urbanizimin e zonës, kemi punuar në mënyrë intensive gjatë gjithë kësaj kohe, në mënyrë që të kemi një plan të detajuar të zhvillimit të zonës dhe të dyja brigjet e lumit. Duke pasur mundësi të kemi një plan zhvillimi, krijojmë mundësinë që, teksa bëhen punimet për rehabilitimin e lumit, të zhvendosim banorët që duhet të lëvizin nga ajo zonë, të sjellim edhe të gjithë infrastrukturën mbështetëse, si çerdhe, kopshte, rrugë sekondare, për ta shndërruar atë në një lagje të qytetit, të re e funksionale. Mjafton të kujtojmë si ka qenë njëzet e dy-njëzet e tre vjet më parë segmenti nga Bërryli deri te Materniteti i Ri, kur lumi edhe atje ndiqte pak a shumë rrjedhën natyrore, dhe si është zhvilluar më pas, duke u shndërruar në një zonë decente, relativisht të mirë urbane. Ai është pak a shumë një rast, për të kuptuar vizionin se si do të marrë zhvillim edhe kjo zonë gjatë viteve në vijim me sjelljen e këtij projekti.

Nga materniteti e tutje sapo ka mbaruar puna, dhe do të fillohet menjëherë me vegjetacionin. Tani po flasim për segmentin tjetër. Nuk ka qenë pjesë e punës së kontraktorit,

për të pasur vegjetacion të lartë, pra pemë. Në momentin ë të na kalojë si aset, ne do të bëjmë vegjetacionin dhe mund të siguroheni se brenda një a dy vjetësh do të jetë njëlloj si pjesa tjetër.

Niko Peleshi – Zoti Bici.

Dritan Bici – Për pyetjen e parë që bëra mora përgjigje korrekte, por unë po mendoja diçka ndryshe: po mendoja një projekt që të përfshinte ujërat e zeza. Sipas mendjes sime, duke mos qenë inxhinier, mendova se ndoshta po fillonte një projekt i ri për Lanën, që ujërat e zeza të hyjnë poshtë në kanal, ndërsa sa i takon pjesës sipër, të merret ndonjë degëzim nga Lumi i Tiranës, për të pasur edhe Tirana një lumë në mes, pa ujëra të zeza.

Faktikisht, ky qenka një projekt urbanizimi, i cili është në vazhdim të këtyre projekteve të tjera. Unë e mbështes këtë projekt, sepse është një projekt i mirë, i cili duhet të vazhdojë. Prandaj bëra edhe një pyetje: a ka ndonjë projekt të përgjithshëm për sa i përket lumit të Lanës në përgjithësi? Duke që është një projekt i mirë, që duhet të vazhdojë, por unë do të bashkoja votën kundër me gjithë opozitën, duke mos e dhënë votën në favor të këtij projekti, përderisa nuk ka një marrëdhënie të bashkisë me çdo familje, së cilës do t'i priset shtëpia. Ndoshta do të thoni që përbën lajm fakti se një deputet i maxhorancës bashkon votën me opozitën, por unë do të thosha se ne, Partisë Socialiste, na ka kushtuar shumë ai projekti i Unazës së Re, i cili u përfol edhe për korrupsion. Sikur ca nga ato lekët e korrupsionit t'u ishin dhënë atyre familjarëve për të ndërtuar shtëpitë, Unaza e Re nuk do të ishte bërë qëndresë, rezistencë dhe qendër e rezistencës së protestave të opozitës. Pra, deri në atë kohë, opozita nuk kishte asnjë lloj kauze, por që nga ai moment iu dha një kauzë nëpërmjet një projekti, i cili kishte brenda edhe dyshimi për korrupsion.

Pikërisht për këtë arsye, arsye të cilat bashkia thotë se i ka në konsideratë... Sepse ata njerëz nuk janë kafshë. Ata kanë ardhur si kanë ardhur, por ai është faji i shtetit, i atij shteti që ishte atëherë dhe i këtij shteti që është tani. Shteti duhet të mbajë përgjegjësi për çdo familje që banon aty, që të mos na fillojë një rezistencë e dytë. Bashkia duhet të ketë një marrëdhënie kontraktore tek për tek me çdo familje aty. Në qoftë se ndodh kjo, e jap votën. Përndryshe, nuk e jap votën, nuk e bashkoj votën në dëm të atyre fatkeqëve.

Faleminderit!

Niko Peleshi – Zoti Beqaj, kishit diçka?

Ilir Beqaj – Po.

Niko Peleshi – Fjalën e ka zoti Beqaj. Më pas zoti Shtjefni.

Ilir Beqaj – Praktikisht, duam apo s' duam, gjurma ku kalon përroi i Lanës është edhe vend ku mblidhen mbeturina të ndryshme urbane. Ju po zbatoni një projekt tjetër në këto

shkarkimet e mëdha, siç është edhe ky që u bë në Rrugën e Elbasanit. Praktikisht, prerja aty është goxha e madhe. Aty, në vende të tjera dhe përgjatë gjithë gjurmës së Lanës, ku vinë shkarkimet, a keni ndonjë plan për të bërë prita të caktuara, në formë rrjetash, në mënyrë që mbeturinat urbane, të cilat do të vazhdojnë të mblidhen, të mund t'i administrojmë më me rregull, periodikisht? Kjo, me qëllim që në fund fare, të mos kemi mbeturina në pika të caktuara, ku grumbullohen në mënyrë të parikuperueshme. Sepse, kur ka shumë shi, Lana del sipër, ndërsa kur tërhiqet, në të dyja anët e lumit lë shumë mbeturina, të cilat ngelen aty, ku degradojnë, ndotin mjedisin e të tjera.

Faleminderit!

Besnik Baraj – Kjo ka efekte edhe për të ndaluar gjithë plastikat, që vemi re në raste reshjesh shumë të mëdha, që të mos shkojnë deri në bregdet. Pra, duhet të ketë rrjeta, të cilat i pengojnë këto objekte plastike. Më pas, është bashkia ajo që i mbledh në mënyrë frekvente.

Niko Peleshi – Zoti Shtjefni, po.

Zef Shtjefni – Zoti kryetar, unë shoh se ky është një projekt i vështirë. Do të biem në të njëjtën gjendje, ashtu siç ramë me Astirin. Në qoftë se këta mendojnë t'u japin familjeve tre vjet qira, këta nuk kanë zgjidhur asgjë. Kështu vepruan edhe me ca familje te Astiri, dhe ja si e kemi situatën.

Projekti thotë se janë dyqind e ca familje, dhe në qoftë se deri më sot nuk kanë marrë kontakte me qytetarët, kanë bërë gabim. Edhe sikur ta kalojmë këtë ligj, ky do të jetë i parealizueshëm, sepse do të përballemi me një protestë të madhe qytetare. Këta mendojnë se do të veprojnë si në rastin e Astirit, apo sikundër kanë bërë edhe me disa projekte të tjera. Kështu që, vetëm nuk e jap votën, pa e ditur se si janë shprehur banorët. Ose, ta organizojnë këta vetë punën, me një komision të posaçëm, të marrin kontakt me ato dyqind familje apo sa janë, dhe atëherë le të vijnë tek ne e të marrin votën.

Faleminderit!

Niko Peleshi – Zoti Mazniku, sa është numri i familjeve të palegalizuara? A e keni shifrën? Pra, sa ndërtime pa legalizim janë?

Arbian Mazniku – 210.

Niko Peleshi – 210. Të palegalizueshme?

Arbian Mazniku – Ne e kemi filluar tashmë punën, siç thashë, me mbështetjen e programit të posaçëm të EIB, për identifikimin e secilës prej këtyre familjeve, për elevimin e saktë të gjendjes së secilës prej tyre, anës dokumentare, për të parë se cilat prej tyre mund të jenë. Kemi tashmë një kontakt, një hartë të qartë të familjeve, jemi duke plotësuar edhe më tej anën dokumentare, për të parë se cila prej tyre është e legalizueshme, cila prej tyre është

jashtë kuadrit ligjor të mundësisë së legalizimit, për të pasur volumet e banesave, numrin e banorëve, gjendjen ekonomike të tyre, në mënyrë që të kemi mundësi që secilës tipologji t'i gjejmë zgjidhjen më të përshtatshme të mundshme, në varësi edhe të mundësive që bashkia ka, në varësi edhe të programeve që u përshtaten atyre.

Pra, gjëja për të cilën dua t'i siguroj deputetët, është që nuk do të ketë asnjë rast që do të kalojë pa vëmendje dhe pa marrë zgjidhjen më të mirë të mundshme, për sa i përket këtij shqetësimi.

Ky nuk është projekti i parë i këtij lloji, që bëjmë. Bulevardi i Ri ka qenë edhe më i madh, edhe më me shumë problematika se ky, e në pjesën më të madhe të tij është zgjidhur. Në pjesën e Lumit të Tiranës kemi pasur një ndërhyrje prej 8 kilometrash në të dyja anët e Lumit të Tiranës, në veri të qytetit, po aq kompleks sa ky, por që është zgjidhur, janë evidentuar problematikat dhe debatet. Në lumin e Shkozës kemi pasur edhe aty çështje, dhe jemi duke zgjidhur rast pas rasti secilën nga problematikat.

Padyshim, jemi të ndërgjegjshëm për faktin e do të ketë problematika, por secilin qytetar do ta trajtojmë me respektin, vëmendjen dhe kujdesin që ai duhet të ketë. Për sa i përket çështjes së projektit në tërësi, është një projekt tjetër që po implementohet nga ana e qeverisë, për sa u përket ujërave të zeza të lumit të Lanës, projekt që mbështetet nga qeveria japoneze. Në fakt, është një projekt që ka pasur disa problematika në lidhje me implementimin, por është ai që do të merret me rehabilitimin e ujërave të zeza, horizontalisht, paralelisht me lumin e Lanës.

Duhet theksuar se edhe ky segment, përveç pjesës mbitokësore, që janë rrugët, skarpatat, ka në mënyrën më të mirë mundshme zgjidhjen e të gjithë elementëve nëntokësorë, që do të thotë: kanalizimet e ujërave të zeza, paralelisht kanalizimet e ujërave të bardha, që derdhen aty. Pra, që të gjitha janë zgjidhje që bëhen në mënyrë integrale, së bashku me projektin në vetvete.

Për sa i përket pyetjes së zotit Beqaj, në lidhje me çështjen e pritave, ky është një debat që e kemi bërë shpeshherë. Në thelb, Lana kryen tre funksione. Përveçse ka ujërat e veta standarde, përveçse aty derdhen në mënyrë konstante një pjesë e ujërave të zeza të qytetit, gjë që është një ndër problemet, për të cilat na vjen shumë zor, por kjo është situata, bën evakuimin e ujërave të bardha, ujërave të shiut. Në ato raste kemi volume shumë të mëdha uji.

Pjesë tjetër e problematikës është se në shumë raste, kur volumi i ujit shkon mbi tubacionin që derdhet aty, në atë moment tubacioni nuk shkarkon më. Krijimi i pritave në shtratin ekzistues të lumit, pra në segmentin nga...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Në thelb, i njëjti problem është. Në disa raste, siç patëm shiun e javës së kaluar, që ishte 115 milimetra brenda tre-katër orëve, dhe ka volum të lartë, në qoftë se nuk arrijnë të shkarkojnë dot në Lanë, kthehen mbrapsht dhe na përmbysin lagjet. Prandaj projekti i ri që keni parë në Rrugën e Elbasanit ka një spesor aq të madh, sepse është inxhinieruar, është projektuar për ta shmangur këtë problem, pra të mos ndodhë bllokimi i tij i mundshëm në momente të tilla.

Ne jemi duke kaluar një situatë, e tilla tashmë është gjithmonë e më shumë fakt. Çështja e ndryshimeve klimaterike nuk është teori shkencore. Për tre katër vjetët e fundit, kemi pasur në mënyrë periodike një ose dy episode në vit, reshje me volum të lartë brenda një kohe të shkurtër. Kjo do të thotë se kemi nevojë të bëjmë evakuimin e sasive të mëdha të ujit. Kështu, zgjidhja më e mirë e propozuar nga inxhinierët, është që filtrimi i mbetjeve të jetë në fund të lumit. Pra, jo në det, por saktësisht në fund të këtij segmenti, në zonën kur dalim nga pjesa urbane, duke krijuar mundësinë që uji të evakuohet me shpejtësi nga pjesa urbane, ndërsa pjesa e mbetjeve që transporton uji të kryhet në një pikë fundore.

Niko Peleshi – Zoti Bare.

Besnik Baraj – Kur folët në lidhje me trajtimin e ujërave të zeza dhe thatë: “horizontalisht”, në këtë rast keni parasysh paralelisht me Lanën.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Për të qenë edhe në rezonancë me shqetësimet e deputetëve, të cilët folën këtu në lidhje me banorët që do të duhet të zhvendosen, si dhe asistencën që do t’u ofrojë bashkia: sa kohë ju duhet juve, praktikisht, për të bërë vlerësimin e çdo familjeje, në lidhje me dokumentacionin, ku të jeni të qartë edhe për llojin e asistencës që do t’u ofroni?

Arbian Mazniku – Tashmë ne e kemi bërë një pjesë të madhe të punës, dhe në një periudhë prej 3-4 muajsh nga tani, ne do të kemi një plan të shkruar, që quhet plani i ri i alokimet ose i rivendosjes së banorëve të zonës. Do të jetë një plan specifik me secilën prej familjeve, nëpërmjet një zgjidhje tashmë të diskutuar e të dakordësuar me ta, për të gjithë segmentin. Ky do të jep një hap që do të kryhet para se të kenë filluar punimet.

Niko Peleshi – Po, zoti Pëllumbi.

Arben Pëllumbi – Projekti është i mirëpritur dhe shumë i domosdoshëm, por duke marrë shkak nga tërë ajo zhurmë që është bërë me projektet e mëparshme, sidomos në lidhje me atë që quhet: shpenzime për kilometër, dhe këtu kemi një vlerë që kapërcen 12 milionë euro për kilometër, para se të fillojë kjo zhurma e shpenzimeve për kilometër, a mund të sqarojmë çfarë përfshihet në këtë projekt, pra çfarë keni ndërmend të bëni? Nuk është fjala

thjesht për një rrugë apo për një sistemim lumi. Le të hyjmë pak më në detaje, se me çfarë keni parasysh në këtë investim që ne do të kalojmë.

Arbian Mazniku – Shumë faleminderit për pyetjen, sepse në fakt, në momentin që kemi projekte infrastrukturore, një pjesë e madhe e punimeve jo detyrimisht shihen. Gjendja ekzistuese është një lumë, i cili rrjedh në gjendja natyrore, që do të thotë se rrjedh e lëviz në dhë në mënyrë të natyrshme. Gjendja përfundimtare e projektit do të jetë: lumi në vetvete do të lëvizë në një shtrat të betonuar, siç është pjesa tjetër e lumit të Lanës, që njerëzit e shohin në mënyrë të qenësishme. Do të kemi dy skarpata të ngritura e të gjelbëruara,. Gjithashtu, në secilin prej krahëve të rrugës do të kemi tri korsi të transportit automobilistik, njëra e dedikuar për transport autobusi, ndërsa dy të tjera për transport privat. Do të kemi dy trotuare në secilin prej krahëve, me gjerësi 1, 5 metra. Gjithashtu, në secilin prej krahëve do të kemi korsi të dedikuara për biçikletat. Projekti, nga njëri krah në tjetrin, është 70, 7 metra i gjerë.

Gjithashtu, në këtë projekt janë përfshirë të gjitha punimet e nevojshme nëntokësore, që do të thotë se kemi gjithë rehabilitimin e linjave të ujërave të zeza në zonë, kemi rehabilitimin e ujërave të bardha ose ujërave të shiut, kemi vendosjen e gjithë sistemit të ndriçimit në këtë segment, kemi një urë të madhe në qendër të këtij segmenti. Pra, në mes të këtij segmenti ka një urë, e cila lidh zonën e Kasharit e të Yzberishit në njërin krah, me pjesën e qytetit në krahun tjetër. Është një vepër e madhe brenda këtij projekti, vepër interkonjeksioni për ato dy segmente.

Niko Peleshi – Zoti Beqaj.

Ilir Beqaj – Faleminderit!

Me sa u pa edhe këtu, një pjesë e kolegëve kanë shqetësime, ashtu si edhe ne të tjerët, sa i takon situatës së ardhshme të banorëve që preken nga kjo ndërhyrje, e madje u shprehën se nuk janë gati ta mbështesin.

Unë besoj se ne jemi këtu për të zgjidhur gjërat. Me bllokime, moratoriume e mosbotime nuk është se zgjidhim ndonjë gjë. Në rastin më të thjeshtë, supozojmë se kjo kredi nuk miratohet, do të përdorim parà nga buxheti i brendshëm, të cilat kur të vijnë në parlament, vijnë në zërin e madh të investimeve, dhe përveç se dikush për një moment mund të ketë thënë jo, nuk ka zgjidhur ndonjë gjë.

E dyta, formalisht dhe juridikisht, këto janë hapa që i çelin rrugën këtyre hapave të tjerë. E para, bashkia e Tiranës, si çdo bashki tjetër, funksionon mbi kuadrin tonë ligjor. Në qoftë se ne duam të bëjmë ndonjë ligj të veçantë për dëmshpërblimin e tyre, hajde bujrrëm, le ta bëjmë! Një ligj të veçantë për familjet që preken nga ky projekt. Le ta bëjmë!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Tani, unë ju dëgjova! A mund të mbaroj, të lutem?

Nuk e bëjmë dot më parë. Sepse, po s'bëmë këtë, nuk ka kuptim ajo. Kemi dëshira e projekt-ide për të rregulluar Shqipërinë, ndoshta me trilion dollarë, por në momentin kur vjen ky hap juridik... Edhe ajo puna paraprake që është bërë, është më shumë punë studimore. Puna juridike formale fillon pas intelit juridik, që ndjek çdo punë.

Pastaj çështjet e shpronësimit apo të rehabilitimit, apo edhe të kompensimit, sepse duke mos pasur pronë, fjala shpronësim mund të jetë në diskutim. Ata mund të duhet të kompensohen e të tjera. Madje, edhe nëse sot themi se kompensimi është X lekë, kur ato të dalin pas tre vjetësh, mund të ketë shkuar edhe 20 % më shumë. Ne do të duhet t'u japim atyre aq sa u duhet për të zëvendësuar një standard minimal jetese. Këtë e kemi detyrim të gjithë ne së bashku, në qoftë se janë qytetarët të Republikës së Shqipërisë. Edhe po i lamë në rrugë, prapë ne do të vijmë me një program tjetër buxhetor, për t'ua zgjidhur atë hall. Kjo qoftë edhe për faktin se, një bllokim i dytë i një aksi shumë të rëndësishëm të Tiranës, gjë për të cilën jemi të gjithë të vetëdijshëm, se u bënë tetë muaj, u krijon shumë kosto banorëve dhe biznesit. Sa ndotje shtesë u janë bërë Tiranës vetëm nga ato makina që rrinë ndezur dhe s'lëvizin. Unë nuk besoj se e zgjidh këtë çështje një marrëveshje paraprake e sotme, e cila nuk mund të lidhet pa u miratuar kjo marrëveshje.

Në qoftë se ne duam të trajtojmë problemet e tyre, ato edhe brenda vetes mund të jenë pak të larmishme: dikush është i legalizuar, dikush nuk është i legalizuar, dikush nuk mund të legalizohet, por sigurisht që ka të drejtën, që nga ai filmi i famshëm "Çatia", që e kemi parë qëkurse ishim kalamaj, ka të drejtën e një strehe minimale për të jetuar, madje edhe me standardet minimale për metër katror për banorë. Ama duhet të jemi të ndërgjegjshëm se vetëm duke i hedhur hapat një e nga një mund të arrijmë të zgjidhjet e problemit në mënyrë më të plotë.

Sigurisht, ne do t'i kërkojmë bashkisë, që të jetë sa më e vëmendshme. Edhe instrumenteve të tjera të qeverisë. Kemi edhe Ministrinë e Infrastrukturës si instrument, qeveria ka edhe prefektin, si një ndër personat që merren me atë çështje, por ata ndeshen vit pas viti me njerëz që u kërkojnë dëmshpërblim për përmbytjen. Prapë, kur ra shiu i madh para ca ditësh të lumi, ata prapë filluan. Madje kanë filluar edhe me marifete. Atje ka njerëz që kanë një shpi në një vend, kanë marrë një shtëpi me qira aty, nuk jetojnë, e dinë që përmbytet dhe vit për vit kërkojnë nga 5 milionë. Ka edhe kështu marifetesh.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, nuk është brenda ligjit. Vit për vit të marrësh nga 5 milionë dhe të marrësh një shtëpi me qira sa për të bërë letra për dëmshpërblim, kjo nuk është brenda ligjit. Unë do t'i

kërkoja gjithsecilit që ta shikojmë me pozitivitet. Ne duhet të marrim hapat e nevojshëm që gjërat të jenë të zbatueshme.

Niko Pelelshi – Po, zoti Bici.

Dritan Bici – Sipas logjikës që tha zoti Beqaj...

(Zoti Ilir Beqaj ndërhyrje pa mikrofon.)

Unë e pranoj logjikën tuaj, por ajo logjikë të çon përsëri te “Astiri”. Edhe “Astirin” kështu e kemi miratuar, dhe ja si erdhi puna, ku e ke “Astirin”?! E ke të bllokuar sot. Edhe po ta miratojmë këtë, e njëjta situatë do të jetë, përsëri te “Astiri” do të shkojmë, nëse do të miratojmë projektin...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kompensimin e këtyre dhe të atyre të “Astirit” që të vazhdojë, të hapet projekti. Kudo ku ka probleme të tilla, hajdeni ta bëjmë ligjin dhe bashkia zhblokohet. Nuk ka pse të ngarkohet bashkia. Bashkisë i lumtë, bën projekte zhvillimi, por nuk i takon asaj të merret me qytetarët një nga një. Hajdeni ta bëjmë ligjin e veçantë për secilin që preket, pasi edhe një zogu po t’i prishësh folenë sa shumë qan. A ke asistuar kur i prishet foleja ndonjë zogu, sesa qan, jo t’i prishet shtëpia një njeriu...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Mund të dalin edhe 300. Ne do ta miratojmë, projekti do të fillojë dhe përsëri do të ketë përleshje dhe bllokime.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nismat ligjore ne i kemi në dorë. Hajdeni të bëjmë të parën këtë dhe pastaj i hapet rruga gjithçkaje! Më kuptoni?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Halit Valteri - Zoti Beqaj, zoti Mazniku, a ka ndonjë hapësirë që bashkia të lirohet nga të gjitha përgjegjësitë? Do ta marr unë përsipër, do të diskutoj një nga një me kolegët e maxhorancës dhe të opozitës që të na japin një draft, një program, një mundësi, një alternativë që ne ta kalojmë në parlament, sepse është shumë e thjeshtë, po të ngremë dorën këtu të gjithë, e kalojmë, në rregull, por pas 5 minutash do të harrohet gjithçka, do të vijë në seancë, si në Shqipëri që pas 3 ditësh çudia nuk kujtohet më. Për 210-212 jam dakord, për 200, 150 nuk ka rëndësi, se mund të këtë dhe marrëveshje të tilla, dikush e ka pallat do ta japë për shesh ndërtimi. Na sillni një draft, ta votojmë në parlament dhe të gjithë këta njerëz të kenë një zgjidhje, por jo me këto 3 programe. E thashë edhe një herë që me bonus qiraje, me ndërtimin e banesave sociale dhe nuk e di se me çfarë programi tjetër që ka bashkia, nuk e zgjidhim dot. Nuk po them që t’u ndërtojmë vila, se ka edhe abuzues. Dikush ka vilë

pesëkatëshe, e ka ndërtuar me paratë e tij, pa më pyetur as mua dhe as ty, është lodhur në kurbet si fëmijët dhe vetë, 5 kate shtëpi nga 100 metra për kat bëjnë 500 metra, nga 280 euro që shkon minimumi kostoja e ndërtimit janë shumë para që bashkia e Tiranës apo shteti shqiptar duhet të paguajë. Nuk po flas për këto raste, por një shtëpi ku të fusë kokën dhe të mos ketë detyrime nga një projekt që do të kalojë në të mirën e qytetit, duhet të bëhet. Na jepni mundësinë që ne t'ju lejojmë të bëni punën, këtë projekt madhor që keni nisur për qytetin dhe ta kalojmë në parlament. Do ta marr unë përsipër. Do të vij unë dhe do të qëndroj gjithë ditën te dera e bashkisë derisa t'u japim zgjidhje këtyre njerëzve, edhe Kryeministrit të Shqipërisë do t'i qëndroj te zyra derisa të më presë, me qëllim që t'u japim një zgjidhje këtyre njerëzve. Por të nxjerrim 200 familje në rrugë për 3 vjet bonus qiraje apo t'i fusim nëpër magazina, unë nuk mendoj se janë kafshë.

Niko Peleshi - Faleminderit, zoti Valteri!

Mirë është që të mos e politizojmë më shumë se sa duhet, po flas në përgjithësi, sepse nuk zgjidhen punët me populizëm. Që t'i kërkojmë një bashkie të frenojë projektet e zhvillimit urban, se ne mendojmë që kuadri ligjor i dëmshpërblimit dhe i trajtimit të personave apo familjeve të prekura nuk është i kënaqshëm, kjo nuk është e drejtë, sepse në fund të fundit, siç e tha zoti Beqaj, jam 100% dakord, nëse ne mund të ndërmarrim nisma për të përmirësuar, për të shtuar dhe për të bërë më të drejtë dëmshpërblimin e familjeve të prekura në raste të projekteve të infrastrukturës apo të zhvillimit urban, nuk na ka ndaluar njeri deri më sot. Nuk kemi pse presim që të vijë një marrëveshje dhe t'i themi stop, pastaj të fillojmë punën për të propozuar një trajtim më të drejtë sipas nesh, sepse treni ikën dhe nuk vjen më, sidomos në raport me institucione kaq prestigjioze si Banka Europiane e Investimeve, që kanë edhe afate. Kontratat nëse nuk miratohen digjen dhe nuk janë pak, por janë fonde të mëdha.

Pa dyshim që ka një rrugë të mesme, përsëri i referohem fjalës së zotit Beqaj. Ne nuk kemi pse ta ndalojmë marrëveshjen, ajo duhet të miratohet në kohë, sa më shpejt për mendimin tim, sot edhe në seancën e ardhshme plenare. Më pas jemi të lirë që të llojmë, të propozojmë në qeveri apo kudo masa, të cilat i mundësojnë bashkisë që t'i trajtojë në mënyrë më të plotë familjet e prekura. Nuk ka bashki, pavarësisht nga ngjyrat të majtë apo të djathtë, bashkitë përgjithësisht janë të të gjithë qytetarëve, por nuk ka bashki që nuk do të donte t'i shpërblente sa më shumë qytetarët e saj dhe t'i kishte sa më tepër të kënaqur. Nuk është asnjë bashki në luftë me qytetarët, përkundrazi i ka komunitet dhe është e detyruar, përgjegjëse sipas ligjit që t'i trajtojë sa më mirë, por edhe në raport me politikën dhe me qëllimet elektorale, të cilat janë legjitime do të ishte e interesuar që t'i kishte sa më tepër

të kënaqur. Ne nuk mund t'u lidhim duart bashkive tona, duke u thënë: "Ndërtesat që janë të palegalizuara, ju do t'i trajtoni me masa të cilave ne nuk u kemi dhënë hapësirë në ligj", sepse nuk mund t'i nxjerrim dot nga shtrati ligjor. Do t'u krijojmë një hapësirë më të madhe. Ja ku jemi, ndërmerrni nisma! T'i propozojmë në qeveri, në parlament dhe çdo gjë bëhet e mundur, por marrëveshja nuk duhet të frenohet. Nuk mund të bëjmë doktor Adhamudhin, të dhemb koka, preje kokën! Meqenëse kemi pasur probleme me një projekt, atëherë hajdeni të bllokojmë projektin tjetër! Me bllokim nuk zgjidhim asgjë. Kryeqyteti duhet të ecë përpara, zonat që kanë nevojë për urbanizim do të urbanizohen. Nuk jemi për ta mbajtur situatën siç është, por kostot do t'i përballojmë në mënyrë të drejtë dhe ligjore. Nëse ka nevojë për përmirësim ligji, kuadri ligjor dhe nënligjor, hajdeni që të bëjmë propozime! Kjo është puna jonë e përditshme. Ne nuk jemi zjarrfikës dhe menaxhues krizash.

Halit Valteri - Faleminderit!

Zoti kryetar, në asnjë moment në fjalën time nuk thashë se duhet ta bllokojmë këtë projekt. Jam dakord që të bëhet projekti ta votojmë, madje thashë se do të loboj tek opozita me sa mundësi që të kem që të bëhet ky projekt, por duhet të shikohet sipas gjërave që thashë për banorët. I vetmi shqetësim imi nuk është se po rregullohet Lana, jam shumë dakord që ajo të rregullohet, të bëhet e bukur, të kemi një kryeqytet të pastër, më me pak ndërtesa të çrregullta, por problemi është se si do ta zgjidhim çështjen e këtyre qytetarëve. Unë nuk jam dakord që një person, i cili ka 25 apo 30 vjet që ka ndërtuar një shtëpi, që shteti tek e fundit e la, nuk e la as Mazniku, as zoti Peleshi. Por ne jemi shtet, nuk ndryshon shteti se vijnë qeveri të ndryshme, shteti ka 100 vjet që është i tillë. Atje ka banesa që janë ndërtuar që në vitin 1970, kjo do të thotë se i ka lejuar shteti, pra këta njerëz për sa kohë i ke lejuar që të investojnë... Ju do të thoni, se shteti nuk ka funksionuar në atë kohë, por mua nuk më duhet se nuk ka funksionuar shteti në atë kohë. Shteti të mos i linte të ndërtonin dhe nuk do t'i kishim këto lloj situatash. As zoti Mazniku nuk do të vinte fare këtu që të na jepte shpjegime, se ishte projekt për t'u bërë, por problemi është sesi do t'u japim zgjidhje këtyre njerëzve. Shteti i ka lejuar, shteti hapi legalizimet, bëri amnistinë. Ju erdhët në pushtet me legalizimet falas për çdo banesë. Atëherë, unë nuk jam kundër kalimit të këtij projekti, të gjithë t'i hapim rrugën atij, por na e thoni ju sesi do ta zgjidhim dhe ne jemi të gatshëm të bëjmë çfarëdolloj nisme.

Niko Peleshi - Mesa duket të gjithë jemi dakord që marrëveshja nuk i prish punë çdolloj nisme apo zgjidhjeje, siç e quani ju, problematikave që mund të dalin. Miratojmë sot marrëveshjen, e kalojmë në seancë, me shumë shpresë që të miratohet në seancë. Më pas, qoftë duke lobuar, qoftë duke insistuar dhe duke e ndjekur procesin në vazhdimësi, mund të

bëjmë më të mirën. Të gjithë jemi të interesuar për ta bërë projektin sa më të mirë, sa më cilësor në ndihmë të komunitetit edhe për t'i dëshmshpërblyer ata që preken në mënyrë të drejtë.

Unë propozoj që ta kalojmë marrëveshjen në votim. Kush është dakord me miratimin në parim të projektligjit?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Marrëveshjen financiare që po diskutojmë tani, atë të parën. Po e lexoj që të mos keqkuptohet: projektligji “Për ratifikimin e kontratës financiare ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Europiane të Investimeve për projektin shtrati i lumit Lanë, zhvillimi urban”. Kundër? Dy kundër. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë në votimin nën për nen.

Neni 1. Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 2. Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kush është dakord në tërësi me projektligjin? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin

PROCESVERBAL

Tiranë, më 01.10.2019, ora 12:00

Drejton mbledhjen:

Niko Peleshi – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Shqyrtimi i projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes së grantit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Europiane të Investimeve për projektin “Shtrati i lumit Lana – zhvillim urban” (*Komision për dhënie mendimi*)

Marrin pjesë:

Niko Peleshi , Halil Jakimi, Besnik Baraj, Ilir Beqaj, Gjetan Gjetani, Rrahman Rraja, Andrea Marto, Tatiana Nurçe, Ilir Ndraxhi, Arben Pëllumbi, Robert Bitri, Ardit Konomi, Dritan Bici, Halil Jakimi, Nimet Musaj, Zef Shtjefni, Kujtim Gjuzi, Halit Valteri dhe Ilirjan Pendavinji.

Mungojnë:

Lefter Koka, Arlind Çaçani dhe Eglantina Gjermeni.

Të ftuar:

Belina Ikonomi – Zëvendësministre e Financave dhe Ekonomisë

Tedi Bushaj – Përfaqësues nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Arbi Mazniku – Nënkryetar i Bashkisë së Tiranës

Blendi Klosi – Ministër i Turizmit dhe Mjedisit

Adrian Kamenica – Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit

Enerieta Tarelli – Drejtor juridik në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit

Niko Peleshi - Kalojmë në pikën tjetër: marrëveshjen e grantit për të njëjtin projekt, pra projektligji “Për ratifikimin e marrëveshje së grantit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Europiane të Investimeve për projektin shtrati i lumit Lanë, zhvillimi urban”.

Kush është dakord në parim? Kundër? Dy kundër. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë në votimin nen për nen.

Neni 1. Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 2. Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kush është dakord në tërësi me projektligjin? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Faleminderit!

Tani do t’ju lutesha të qëndronit për pikën tjetër të rendit të ditës: seancën dëgjimore me ministrin e Turizmit dhe Mjedisit, zotin Blendi Klosi, i cili është prezent së bashku me stafin, zëvendësministren, sekretarin e Përgjithshëm, si dhe me përfaqësues të tjerë të ministrisë.

Mirë se keni ardhur, zoti Ministër!

Ministri ka kërkuar që të bëjë një prezantim përpara komisionit tonë. Falënderoj ministrin në emrin tuaj dhe e përgëzoj për nismën në parim për të prezantuar një paketë masash në kuadrin e një politike për të reduktuar burokracitë e fushës së mjedisit, kryesisht të lejeve mjedisore, të inspektimeve, me synim modernizimin që në finale ka mbylljen e rrugës për çdo veprim abuziv, sepse sa më pak burokraci, sa më pak kërkesa të ketë ndaj subjekteve apo qytetarëve, aq më shumë ngushtohen hapësirat për abuzimet e niveleve të ulëta të administratës.